

JANI SOTA

**MËSUESIT E FIERIT NË REFORMËN
SHKOLLORE TË VITEVE
1945 – 1960**

Pas Luftës së Dytë Botërore shkolla shqiptare përjetoj një sërë ndryshimesh radikale që reflektuan edhe në fushën e sigurimit e përgatitjes të personelit mësimor edukativ. Gjatë gjithë periudhës partia në pushtet ndërmori masa të shumta për përgatitjen profesionale të një mësuesi por edhe të gatshëm për të arritur synimin e saj, edukimin e gjeneratave të reja me ideologjinë e saj. Trajtimi i këtij problemi në rrafsh rajonal si pjesë e të tërës, mendojmë se i kontribuon në mënyrë modeste plotësimit të mozaikut të përgjithshëm. Në kuadrin e një artikulli kur problematika është e gjerë dhe e shtrirë në kohë, na duket e përshtatshme fokusimi në aspektet më kryesore pa pretenduar për një trajtim shterues.

*

* *

**Masat e para për përgatitjen
dhe kualifikimin e mësuesve**

Faktori arsimitar në procesin mësimor edukativ ka qenë dhe mbetet i pazëvendësueshëm. Arsimitari është ai, i cili organizon, orienton dhe drejton këtë proces.

Periudha 1945-1960, përfaqëson një nga fazat më interesante në historinë e arsimit shqiptar gjatë të cilës u bënë përpjekje të shumta për krijimin e personelit mësimor i cili, si në të gjithë vendin mungonte edhe në rrethin e Fierit, dhe çka ishte më kryesore për reformimin e tij në përputhje me politikën e shtetit komunist.

Në përfundim të luftës në të gjithë Shqipërinë, në sistemin arsimor numëroheshin rreth 1650 mësues¹. Në prefekturën e Vlorës*, sasia e

¹ *Anuari Statistikor i RPSH*, Tiranë 1958, Kap. X, Arsimi dhe kultura (Të dhënat e vitit 1957-1958), f. 140-141.

* Ndarja administrative. Shqipëria ndahej në 10 prefektura, 39 nënprefektura, 116 komuna dhe 2.711 lokalitete. Fieri dhe Mallakastra, ashtu si në ndarjen e vjetër,

personelit arrin në 138 mësues nga të cilët vetëm 30 kishin arsimin fillor. Pjesa tjetër ishin arsimtarë të karrierës, në pjesën më të madhe me shkollë të mesme dhe vjetërsi të konsiderueshme². Në nënprefekturën e Fierit punonin 66 mësues³. Ata, kryesisht jepnin mësim në shkollat fillore. Ishin me origjinë përgjithësisht nga shtresat e mesme dhe të varfra e me nivel arsimor mesatar. Një pjesë e mirë e tyre kishin marrë pjesë në Lëvizjen Antifashiste dhe besonin, në idealin e krijimit të një shoqërie demokratike.

Zhvillimi i rrjetit të shkollave në Fier menjëherë pas lufte u përballua nga një numër i pakët arsimtarësh. Kuadri mësimor i trashëguar ishte i pamjaftueshëm për t'iu përgjigjur zhvillimit të ardhshëm arsimor të nënprefekturës Fier. Në këtë kuadër, problemi kryesor për zgjerimin e rrjetit shkollor u bë para së gjithash ai i sigurimit të tij.

“Nga zgjerimi i kuadrit dhe për arsye të ndryshme, janë emruar me përqindje të madhe mësuesat filloriste e të karrierës. Për të hedhur baza të reja e për të vijuar puna me rikthimin e duhur, - theksohet në një raport të Komitetit Ekzekutiv të Prefekturës, - është nevojë e domosdoshme që të merren në shërbim të gjithë mësuesit e karrierës, natyrisht, të gjithë ata që do të meritojnë t'iu ngarkohet një barrë e tillë. Veçanërisht kësaj, duhet bërë çdo sakrificë për ndërtimin e shkollave në të gjitha katundet që mungojnë”⁴.

Në momentet e para vëmendje e veçantë, iu kushtua edhe çështjes së organizimit të mësuesve, në një bashkim sindikal më vete, i cili do të mbronte interesat e tyre, por që do të kujdesej edhe për edukimin politik. Duhet theksuar fakti se deri në shkurt të vitit 1945, organizimi i mësuesve, kishte thjesht karakter lokal. Organizatat sindikale, që ishin formuar në bazë të profesionit dhe territorit nuk përfaqësonin një organizatë qendrore kombëtare, me rregullore apo statut ku të përcaktohej, veç të drejtave e detyrave edhe skema e organizimit të tyre nga organet udhëheqëse të qendrës në ato të bazës.

gëzonin statusin e nënprefekturave. Këto të fundit se bashku me nënprefekturën e Himarës ishin në varësinë administrative të prefekturës së Vlorës.

² Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 489, viti (më tej: V.) 1945, dosja (më tej: D.) 132, fl. 106-118. Raport i komitetit ekzekutiv të prefekturës Vlorë.

³ Arkivi Shtetëror Vendor Lushnje (më tej: ASHVL), Fondi 117, viti 1945, dos. 86, fl. 4.

⁴ AQSH, F. 489, V. 1945, D. 132, fl. 122-125. Raport i përgjithshëm i muajit qershor 1945 i komitetit ekzekutiv të prefekturës Vlorë.

Pavarësisht nga kjo, në sindikata bënë jetën e tyre të organizuar të gjithë mësuesit dhe punonjësit e tjerë, që jepnin kontributin e tyre në arsim. Sipas traditës klasike, sindikata duhej të ishte e destinuar, të mbronte të drejtat e punonjësve nga çdo padrejtësi apo arbitraritet i administratës shtetërore, duke qenë kështu si një opozitë, ose të ishte të paktën në oponencë me të. Realisht, ajo u bë një levë e partisë në pushtet.

Fillimisht organizata e mësuesve në Fier, drejtohej nga Këshilli Administrativ i Sindikatës të nënprefekturës, e cila ishte e varur nga ajo e prefekturës së Vlorës⁵. Pas krijimit të Bashkimit të Përgjithshëm Provizor të Sindikatave, më 11 shkurt 1945, u krijuan kushte që organizimi i mësuesve, të bëhej në bazë të një strukture më specifike. Rol të rëndësishëm për organizimin e punonjësve në sindikata, luajti udhëzimi i 2 shtatorit 1945⁶, mbi punën përgatitore për organizimin e Kongresit I Kombëtar të Sindikatave ku u theksua, që Kongresi të mos gjente jashtë sindikatave asnjë punëtor e intelektual. Udhëzohej, gjithashtu, që të bëheshin të gjitha përpjekjet për të forcuar aleancën midis punëtorëve, fshatarësisë punonjëse dhe intelektualëve, si nevojë e domosdoshme për të siguruar dhe konsoliduar fitoret e arritura në rindërtimin e vendit⁷.

Deri në verën e vitit 1946, mësuesit bënë pjesë në Bashkimin Sindikal të Nëpunësve, të krijuar pas Kongresit I Kombëtar të Sindikatave që u mbajt më 26-30 mars të vitit 1946⁸, i cili "*... do të merrej me edukimin, aktivizimin, mësimin, drejtimin dhe administrimin e nënpunësve" dhe do të shërbente si "rezervuar" i pushtetit shtetëror*"⁹. Më 1 dhjetor 1946 u mbledh Kongresi i Bashkimit Profesional të Arsimit dhe Kulturës, që zgjodhi edhe organet udhëheqëse dhe miratoi statutin, duke shënuar fillimin e një etape të re në organizimin e arsimtarëve. Sipas tij, Bashkimi Sindikal i Arsimtarëve të Nënprefekturës Fier, kishte në varësinë e vet degët sindikale (organizatat sindikale) të cilat formoheshin në çdo shkollë.

Dega sindikale, kishte pavarësinë për zgjidhjen e të drejtave të mësuesve dhe në të njëjtën kohë, në bazë të parimit të centralizimit demokratik, i nënshtrohej udhëheqjes së forumit të lartë, përgjigjeje para

⁵ Arkivi i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë (më tej: AQBPSH), Fondi Nr. 657, viti 1945, dos. 4, fl. 63.

⁶ Po aty, dos. 5, fl. 1.

⁷ Po aty.

⁸ Po aty, viti 1946, dos. 6, fl.1-4.

⁹ Po aty, fl. 4.

saj, zbatonte direktivat dhe udhëzimet e saj. Sindikatat e arsimtarëve dhe degët sindikale drejtoheshin nga Këshilli dhe Kryesia e tij, kurse në krye të nëndegës (shkolla) qëndronte një mësues- përgjegjës, që bënte pjesë në këshillin e degës. Qëllimi i këtij organizimi ishte mbajtja nën kontroll si e kuadrit ekzistues ashtu edhe atij të ri që do të përgatitej.

Kryesorja për organet shtetërore e partiake, ishte jo vetëm sigurimi i një numri sa më të madh arsimtarësh, por përgatitja e një mësuesi "të ri", që të pranonte politikën e partisë-shtet dhe, të ishte i gatshëm ta mbronte atë. Mbi këtë bazë, u punua si për rritjen e personelit mësues, ashtu edhe për edukimin komunist të mësuesve të vjetër dhe të rinj. Këto u bënë edhe dy, nga drejtimet kryesore të politikës zyrtare shqiptare të pasluftës¹⁰.

Viti shkollor 1944-1945, ndonëse tepër i vështirë, u mbyll me disa tregues modest. Krahas ndërtimit të disa shkollave të shkatërruara, u rrit edhe numri i mësuesve, duke kapur shifrën 1743 në shkallë vendi prej të cilëve 66 mësues, i takonin Nënprefekturës së Fierit¹¹. Për nevojat e zhvillimit të shpejtë të arsimit u punua që mësuesit ekzistues të viheshin në shërbim, si dhe, u ndërmorën disa masa të shpejta për rritjen e numrit të tyre. Fillimisht, u angazhuan edhe ata elementë, që deri-diku u mungonin njohuritë profesionale, por që kishin një farë arsimit. Kuadri mësues, sidomos ai i fshatit, jo rrallëherë, u plotësua me elementë, që kishin vetëm arsimin fillor si dhe me të tjerë që, kaluan në disa kurse të shpejta për mësimdhënie.

Siç dihet në gushtin e vitit 1946 u aprovua Ligji i Reformës Arsimore, një nga më të rëndësishmit e periudhës së pasluftës. "Ajo hodhi bazat e plotësoi pamjen e sistemit të ardhshëm arsimor dhe të një shkolle të orientuar që mbështeti veprimtarinë e saj në një ideologji të vetme, marksizëm-leninizmin"¹².

Në këtë kontekst përgatitja shkencore dhe pedagogjike, ishte një kusht i nevojshëm por edhe i domosdoshëm për realizimin e reformës. Në vitin 1946, një pjesë e kuadrit mësues fierak, ndoqi kurset e thjeshta lokale dhe ato kombëtare për mësues, siç ishte ai në Tiranë, i quajtur "kursi i madh i kuadrove" ku u përgatitën 400 mësues të rinj për shkollat

¹⁰ Eriketa Kambo, *Arsimi në Shqipëri 1945-1960*, Tiranë: "Mësonjëtorja", 2005, f. 84.

¹¹ ASHVL, F. 117, V. 1945, D. 86, fl. 19.

¹² E. Kambo, *Arsimi në Shqipëri...*, f. 37.

filllore dhe 8 kurse perfeksionimi me mësues të qyteteve¹³. Gjithashtu, “Gjatë verës asht organizuar një kurs në qëndër, - do të theksohej në një raport të Komitetit Ekzekutiv, - ku morën pjesë 54 arsimtarë. Në këtë kurs u zhvilluan një sërë referatesh në lidhje me ngritjen ideologjike, profesionale, pedagogjike t’arsimtarëve janë formuar seminarët ku në bazë të një programi të caktuar punohet lënda e përgatitur”¹⁴.

Në tetorin e vitit 1946, Ministria e Arsimit, bëri një shpërndarje të ri të kuadrit edhe në rrethin e Fierit. Inspektorëve që në shkollën e re, u quajtën ndryshe, edhe mësuesit e mësuesve, iu ngarkua detyra, jo vetëm e kontrollit, por edhe e ndihmës nga afër.

Në vitin 1947, në rrethin e Fierit, vazhduan kurset dhe i përfunduan ato, 12 mësues për shkollat unike (7 vjeçare). Më vonë, në vitin 1948 ndër 243 mësues të rinj të përgatitur në Vlorë, një pjesë e mirë ishin nga zona e Fierit. Elementët pjesëmarrës në përgjithësi ishin me arsim fillor dhe një pjesë e tyre vetëm me 2-3 klasë fillore. Sipas planit të Drejtorisë së Kuadri, në shkallë vendi, “... nga 2.622 arsimtarët e shkollave fillore rreth 1000 mësues janë me normale të plotë ndërsa të tjerët kanë kryer vetëm disa klasë të shkollave të mesme. Përveç kësaj janë pajisur me një kulturë të cekët dhe me pedagogji e metodika të vjetra dhe shumica e tyre kanë një përgatitje politike e ideologjike që nuk pajtohet me frymën e re”¹⁵. Rreth 45% e kuadrit të arsimit fillor, u përgatitën dhe u kualifikuan nëpërmjet formave të përsheptuara. Për rrethin e Fierit sipas statistikave, në vitin shkollor 1947-1948 u kualifikuan 84 mësues, nga 170 mësues gjithsej, ose 49% e kuadrit të arsimit fillor¹⁶.

Për sa i takon personelit të shkollave unike, si do të theksohej në një dokument të kohës edhe ai “... ka një përgatitje anallogje me atë të arsimit fillor, bile këtyre u mungon fare përgatitja pedagogjike”¹⁷. Kjo kategori shkollore në rrethin e Fierit, ishte më e pakët lidhur kjo me ecurinë e ngadalshme të saj, veçanërisht në fshat. Me gjithë vështirësitë që ekzistonin dhe kushteve ekonomike që kalonte rrethi, kuadri mësimor më së shumti u sigurua nëpërmjet angazhimit të elementeve me arsim

¹³ *Bashkimi*, dt. 12 dhjetor 1946.

¹⁴ *AQSH*, F. 490, V. 1946, D. 226, fl. 153.

¹⁵ *Po aty*, F. 511, V. 1947, D. 24, fl. 45. Plani i Ministrisë së Arsimit: Për përgatitje kuadrosh gjatë vitit 1947.

¹⁶ *ASHVL*, F. 117, V. 1947, D. 52, fl. 17.

¹⁷ *AQSH*, F. 511, V. 1947, D. 24, fl. 45.

pedagogjik të papërfunduar, apo duke tërhequr mësuesit më të mirë nga arsimi fillor.

Organet arsimore në qendër dhe në bazë morën masa të shpejta organizative për plotësimin e shkollave me kuadrin mësimor të nevojshëm, sidomos në vitin e parë të zbatimit të Reformës Arsimore. Kështu, në planin e Ministrisë së Arsimit, për vitin shkollor 1947-1948, do të theksohej, se: *“Për t’i plotësue shkollat me personel mësimor që kemi sot do të veprohet në këtë mënyrë: a) shkollat fillore të katundeve me 3 klasë, që nuk kapërcejnë numrin e nxënësve 100 do të kenë vetë një fuqi mësimore; kurse n’ato me 4 klasë do të shtohet një mësues vetëm kur numri i nxënësve është m’i rreth se 80. b) nëpër qytetet shkollat fillore, do të punojnë me sistem gjysëm dite, numri i përjavshëm i orëve do të zbritet në 24 dhe mësuesi veç klasës së tyre që i mësojnë në mëngjes, do t’i japin edhe dy orë mësim pas dreke në një klasë tjetër¹⁸”.*

Për përgatitjen e kuadrit, sidomos atij për shkollat 7-vjeçare, u shfrytëzua rrjeti i shkollave të mesme pedagogjike. Për këtë qëllim, gjatë vitit shkollor 1946-1947, u hap një shkollë e re në Berat, si dhe një degë brenda liceut të Shkodrës, të cilat u frekuentuan edhe nga kuadrot e ardhshëm fierakë. Shkollat pedagogjike, në atë periudhë, kishin një rëndësi të madhe. *“Me anë të nxënësve që mbarojnë këto shkolla ne mendojmë me përhapë metodat e reja pedagogjike, - thuhej në një raport të Ministrisë, - që shërbejnë me përmirësue kualitetin e edukatës e të mësimin në shkollat fillore. Nuk lejohet ma që nxënësit e rinj të trashëgojnë të gjitha ato të meta ... tue fillue nga formalizma etj.”¹⁹*

Pozitivisht, ndihmoi edhe zhvillimi i arsimit të lartë. Në tetor të vitit 1946, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.135, u hap e para shkollë e lartë në vendin tonë, Instituti Pedagogjik me afat fillimisht 2-vjeçar dhe më vonë 3-4 vjeçar²⁰. Tri fakultete, Gjuhë-Letërsi Shqipe, Matematikë, Fizikë dhe Shkenca Biologjike e Kimi-Gjeografi, përgatishnin mësues për shkollat 7-vjeçare dhe të mesme. Mjaft nxënës nga Fieri që kishin përfunduar arsimin e mesëm, ndoqën ndër vite mësimet në këtë Institut.

Në korrik të vitit 1948, u hap një kurs i ri për rikualifikimin e arsimtarëve, të dalë prej kurseve jo të rregullta, gjë që tregon edhe një

¹⁸ AQSH, F. 511, V. 1948, D. 10, fl. 7.

¹⁹ Eriketa Kambo, *Zhvillimi i revolucionit kulturor në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948*, Tiranë: “Shtypshkronja e Re”, 1982, f. 57.

²⁰ AQSH, F. 511, V. 1947, D. 5, fl. 14.

herë se kualifikimi ishte një proces i vazhdueshëm. Në të, u kualifikuan 270 mësues gjithsej, prej të cilëve 16, ishin nga prefektura e Vlorës²¹. Masat e marra për përgatitjen e personelit mësues si nga organet drejtuese të arsimit në qendër, ashtu edhe nga ato në bazë, ndikuan në zbutjen e problemit të sigurimit të kuadrit arsimor, veçanërisht për shkollat fillore, që përbënin shumicën.

E rëndësishme për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrit, ishte vendosja e sistemit të korespondencës. Me vendim të Këshillit të Ministrave, të shtatorit të vitit 1948, të gjithë arsimtarët, që nuk kishin përfunduar shkollën 7-vjeçare, shkollën e mesme apo shkollën pedagogjike detyroheshin ta kryenin atë me korespondencë. Përfundoheshin nga ky vendim, vetëm arsimtarët me një stazh pune mbi 15 vjet²².

Deri në këtë periudhë vijimi i tyre ishte fakultativ, Ministria e Arsimit, kujdesej kryesisht vetëm për dërgimin e dispensave, apo të udhëzimeve e të programeve. Në Fier, gjatë kësaj kohe u ngrit një qendër e veçantë konsultimi që shërbeu për regjistrimin vullnetar të mësuesve. Të gjitha format e përdorura, pavarësisht shkallës së efikasitetit të tyre, ndikuan në ndryshimin sado pak të nivelit kulturor e profesional të mësuesve duke krijuar njëkohësisht edhe kushte, për rritjen e nivelit cilësor të procesit mësues-educativ, që realisht ishte i pamjaftueshëm.

Ngritja e nivelit profesional të mësuesve ishte një çështje që kushtëzonte vetë rezultatet e shkollës. Në këtë kuadër u përdorën forma pune standarte për të gjithë vendin, të cilat natyrisht u aplikuan edhe në rrethin e Fierit. Kualifikimi nëpërmjet kurseve dhe shkollave të rregullta, ishte një formë që ndihmonte së tepërmi në zgjidhjen e problemit të plotësimit të nevojave me kuadër. Por, për përgatitjen e duhur profesionale u përdorën edhe forma të tjera pune, si rrethet metodike dhe seminarët të cilat u aplikuan sidomos për ngritjen ideologjike e politike. Rëndësi të madhe në këtë drejtim, luajti edhe revista “Arsimi popullor” në të cilën diskutoheshin gjerësisht probleme nga më të rëndësishmet. Në një Qarkore të Ministrisë së Arsimit shprehej besimi, se: “... seminarët, rrethet metodike, shtëpitë e mësonjësit dhe këshillat pedagogjike, në të ardhmen do të ndryshojnë gjendjen e sotme të arsimit”²³.

²¹ *Po aty*, F. 490, D. 66, fl. 18.

²² *Po aty*, V. 1946, D. 787, fl. 113. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 226, dt. 29. 9. 1947.

²³ *AQSH*, F. 511, V. 1947, D. 15, fl. 11. Qarkore e Ministrisë së Arsimit, Nr. 17/1, dt. 24.1.1947.

Format më të përhapura të kualifikimit në rrethin e Fierit, ishin: shtëpitë e mësuesit, kabinetet pedagogjike, rrethet metodike, konferencat arsimore, kurset, shkollat me korespondencë. Ato shërbyen për përgatitjen dhe ngritjen pedagogjike dhe profesionale të kuadrit arsimor²⁴. Si do të tërhiqej vëmendja në një dokument të kësaj periudhe duke folur për rëndësinë e problemit të përgatitjes metodike të kuadrit kjo çështje “... nuk duhet të mbetet vetëm problem i arsimtarëve dhe i seksionit të arsimit, por në radhë të parë një problem i rëndësishëm për vetë organizatën e partisë ...”²⁵.

Në qytetin e Fierit, *shtëpia e mësonjësit* filloi nga funksionimi që në vitin 1947. Ajo u kthye në qendra ku zhvilloheshin aktivitetet politike-shoqërore, arsimore të cilat frekuentoheshin nga mësuesit e qytetit dhe të fshatrave përreth. Pranë saj, vepronte Këshilli i arsimtarëve, i cili u kujdes për kualifikimin profesional dhe rritjen e nivelit kulturor të mësuesve. Ai shpërndante materialet teorike në ndihmë të mësuesve të shkollave fillore dhe atyre unike 7-vjeçare, orientonte dhe kontrollonte futjen e metodave të reja mësimore.

Rrethet metodike u organizuan nga seksioni i arsimit të rrethit dhe kishin për qëllim të udhëzonin dhe ndihmonin për ngritjen profesionale të mësuesve të shkollave fillore, shkollave unike, si dhe të drejtuesve të kurseve për luftën kundër analfabetizmit. Që metodat e reja shkencore të studioheshin dhe të zbatoheshin në shkollë, Ministria e Arsimit udhëzonte, që rrethet metodike, të organizoheshin në të gjitha shkollat dhe në to të merrnin pjesë të gjithë mësuesit pa përjashtim²⁶.

Puna metodike me të gjithë mësuesit e rrethit, praktikisht paraqiste vështirësi. Territori ishte shumë i hapur, mjetet e komunikacionit mungonin. Mësuesit më së shumti detyroheshin të flinin në katundet përreth qytetit. Shpesh ata, kërkonin nga organet e arsimit të rrethit që puna metodike të bëhej në zona. Por edhe kjo, paraqiste vështirësitë e veta, sepse mungonin mësuesit e kualifikuar për t'i drejtuar ato. Për këtë qëllim në vitin 1946, kërkohen mësues normalistë që të drejtonin rrethet metodike dhe kurset e kualifikimit të mësuesve²⁷.

²⁴ E. Kambo, *Arsimi në Shqipëri...*, f. 86.

²⁵ *AQSH*, F. 490, V. 1946, D. 226, fl. 153.

²⁶ E. Kambo, *Arsimi në Shqipëri...*, f. 88.

²⁷ *Po aty*.

Për një organizim dhe funksionim sa më të mirë të rretheve metodike, Seksioni i Arsimit, jepte udhëzime dhe ushtronte kontroll të rregullt nëpërmjet inspektorëve të saj. Çdo rreth metodik, si në gjithë vendin mblidhej të paktën dy herë në javë, dhe drejtohej nga mësuesit më të kualifikuar e të përgatitur profesionalisht, si dhe nga inspektorët e arsimit²⁸.

Në veprimtarinë e rretheve, konstatoheshin edhe të meta, si mosfrekuentimi i rregullt nga ana e pjesëmarrësve, rezultate të dobëta në përvetësimin e materialeve metodike, etj. Gjithsesi, rrethet metodike në Fier, pavarësisht dobësive, ndihmuan në drejtim të kualifikimit të kuadrit arsimor si në qytet ashtu edhe në fshat. Në periudhën 1946-1947, u ngritën 8-rrethe metodike, të cilat i ndiqnin 53 mësues të fshatrave, që jepnin mësim në shkollat fillore dhe drejtoheshin nga arsimtarët më me eksperiencë²⁹.

Ritmet e zhvillimit të arsimit në Fier, ndikuan drejtpërdrejt në rritjen e kërkesave për kualifikimin e personelit mësimor, të cilat rrjedhimisht çuan në shtimin e numrit të rretheve metodike. Detyrë e rëndësishme për personelin e Seksionit të Arsimit në rreth, në këtë periudhë, ishte edhe aktiviteti propagandues për të sqaruar dhe për të aktivizuar sa më tepër mësuesit, në problemet e ndryshme që shtronte koha. *“Në qoftë se seksionet e arsimit do t’i japin rëndësinë që meriton, - theksohej në një udhëzim të Ministrisë, - kjo çështje ... së shpejti ka për të gjetur rrugën e saj dhe arsimtarët do të lozin si duhet rolin e tyre”*³⁰.

Në vitin shkollor 1947-1948, u ngritën dhe funksionuan edhe 16 rrethe metodike të tjera, prej të cilave: “2 rrethe për mësuesit e shkollave 7-vjeçare, 4 rrethe për mësuesit e shkollave filloreve të qytetit si dhe 10 rrethe metodike për mësuesit e filloreve dhe të katundeve. Numri i pjesëmarrësve në këto kurse arrinte në 102 mësues, nga të cilët 68 ishin mësues që jepnin mësim në shkollat fillore të katundeve”³¹.

Pranë shkollave, vepronin gjithashtu edhe *Këshillat Pedagogjike*. Shkollat e mesme, këshillin pedagogjik e kishin më vete, kurse ato të fshatrave, së bashku me 7-vjeçaren³². Këshillat pedagogjike ishin organe

²⁸ *Po aty.*

²⁹ *Po aty.*

³⁰ *AQSH*, F. 511, V. 1947, D. 17, fl. 3. Qarkore e Ministrisë së Arsimit Nr. 1080, dt.10.8.1947.

³¹ *Po aty.* V. 1948, D. 5, fl. 2.

³² *Po aty.*

këshillimore në vartësi të drejtorit të shkollës. Ato luanin një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punës së saj dhe funksiononin sipas kritereve që përcaktonte rregullorja e shkollës.

“Janë formuar në çdo shkollë, do të thuhej në një informacion të Ministrisë së Arsimit gjatë kësaj kohe, Këshillat Pedagogjike që studjojnë çështjet teknike dhe administrative shkollore t’arsimtarëve. Pas të gjitha këtyre formave organizative asht kërkuar që arsimtarët t’i adaptohen frymës së re dhe të aplikojnë metoda të reja pune, disiplinë dhe rregull të ri, simbas frymës dhe karakterit të Pushtetit t’onë”³³.

Një ndihmesë në përmirësimin e nivelit të kuadrit mësimor, si nga ana teorike ashtu edhe nga ajo praktike do të kishte, provimi i stazhit, i cili jepej 4 vjet pas përfundimit të shkollës normale. *“Nuk mjaftojn që ne të nxjerrim gjith kuadrot e arsimit që do t’i nevojiten vendit t’onë, - thuhet në një raport të Ministrisë, - por duhet që këtyre kuadrove t’u apëm të gjitha ndihmat e nevojshëm për përmirësimin e tyre në pikëpamje teknike”³⁴.*

Të gjitha këto masa të para të ndërmarra në fushën e përgatitjes e kualifikimit të kuadrit arsimor ndikuan pozitivisht në rritjen sado pak të nivelit cilësor të procesit mësimor në të gjithë shkollat e rrethit të Fierit.

*

* *

Në vitet e para të pasluftës, rëndësi e veçantë iu kushtua edhe problemit të trajtimit dhe vlerësimit të mësuesve. Individë nga institucionet arsimore të mëparshme, u bënë pjesë e administratës dhe institucioneve të ndryshme sepse ishin specialistë të mirë në fushën e mësuesisë. Pjesa më e madhe e mësuesve, me origjinë përgjithësisht nga shtresat e mesme dhe të varfra synonin vijimin e punës normale në shkollë. Jo pak prej tyre kishin qenë të mobilizuar në radhët e Lëvizjes Antifashiste. Ata u tërhoqën nga ushtria për të punuar si të parët mësues në rrethin e Fierit³⁵.

Si pjesë e administratës shtetërore, punonjësit e arsimit para se të lidhnin marrëdhënie pune, ishin të detyruar të kishin këto dokumenta: certifikatën e nënshtetësisë, certifikatën e lindjes, certifikatën e paraqitjes së familjes pranë komitetit ekzekutiv të vendit, certifikatën nga sekretari i

³³ AQSH, F. 490, V. 1947, D. 226, fl. 153.

³⁴ Po aty.

³⁵ ASHVL, F. 117, V. 1945, D. 33, fl. 2.

punëve të brendshme për të dëshmuar se nuk ishin të dënuar, çertifikatën e mjekut dhe dëftesën e shkollës së kryer³⁶. Nga ana tjetër çdo dikaster vepronte mbi bazën e udhëzimeve standarde për plotësimin e disa fletë-biografive ku duhej të shënohej, citojmë:

1. *“Në shtyllën që flet mbi nëpunësin dhe rrogën fillestare të nëpunësit, të shënohet nëpunësija dhe rroga bazë e fillimit, d.m.th. ajo e janarit 1945.*

2. *Për pikën ku kërkohen titujt e studimit, një pjesë nëpunësish i kanë dokumentat e tyre me kohë pranë dikasterevet, por duhet të shënojnë me saktësi ç’titull studimi posedojnë dhe në fund të rrjeshtit, në kllapa, të shënojnë Dikasterin se ku ndodhen këto dokumenta mbasi ka nëpunës që kanë ndryshuar dikasteret për arsye shërbimi”³⁷.*

Në rast se, një pjesë nëpunësish, për arsye të ndryshme kishin humbur dokumentet, atëherë ata duhet të *“... shënonin vetëm titullin e dokumentit, ose kohën ekzakte të studimeve që kanë ndjekur në shkollat e mesme ose në fakultete; duke bërë dallimin mirë në mes regjistrimit dhe vazhdimit të studimeve për një kohë të caktuar dhe që për një arsye ose për një tjetër nuk kanë mundur t’i kryejnë studimet komplet”³⁸.*

Gjithsesi, deri në vitin 1945, problemi i procedurës së emërimit, transferimit, pushimit etj., të nëpunësve, megjithëse ishte shtruar në udhëzimet e qarkoret e ndryshme të Kryeministrisë, në këtë periudhë nuk kishte marrë një formë të përcaktuar e uniforme, si në qendër ashtu edhe në qarqe. Zgjidhja e këtij problemi, në të gjithë kompleksitetin e tij, kërkonte natyrisht një studim të hollësishëm, mbasi në të përmblihet hartimi i tabelës organike të drejtë për të gjithë nëpunësit, gjendja e tyre juridike, disiplinimi i tyre, akordimi i lejeve etj.³⁹.

Sipas një Qarkoreje të Kryeministrisë Nr. 715/2 të datës 4 shtator 1945 *“Komitetet Ekzekutive të Prefekturave dhe N/Prefekturave kanë të drejtë të propozojnë elementa që u nevojiten në Seksionet e ndryshme, por në asnjë mënyrë nuk do të marrin në shërbim nëpunësa, pa u ardhur aprovimi nga qendra”⁴⁰.* Një veprim i tillë, bënte të mundur ekzistencën e kontrollit, që duhet të kenë organet qendrore mbi personelin vartës, si dhe

³⁶ *Po aty*, F. 117, V. 1945, D. 26, fl. 13.

³⁷ *AQSH*, F. 511, V. 1945, D. 31, fl. 27. Dokumenti i Kryeministrisë Nr. 715/25, dt. 30.10.1945.

³⁸ *Po aty*.

³⁹ *Po aty*, fl. 30.

⁴⁰ *Po aty*.

eliminonte ato veprime neglizhence ose paaftësie, që kishin të bënin me shkarkimet dhe punësimet e njëkohshme prej organeve shtetërore.

Për sa i takon transferimeve prej një shkolle në tjetrën, çdo kandidat, duhej të paraqiste kërkesë me shkrim në komitetin ekzekutiv, seksionit të arsimit, deri më 1 qershor të vitit përkatës shkollor. Kërkesa të tilla, ishin të shumta për shkak të gjendjes së vështirë materiale dhe dëshirës për të punuar sa më afër vendbanimit të tyre. Në këto vite të para paga mesatare e mësuesit llogaritej 850 fr.shq. pavarësisht nga puna që kryente dhe vitet e shërbimit.⁴¹ Lidhur me trajtimin financiar Ministria e Arsimit, do të udhëzonte në vitin 1945, Seksionin e Arsimit, se: “... në caktimin e rrogës bazë me karakter provizor për personelin e kuadrit t’Arsimit Filluer keni parasysh edhe këtë:

I. Mësuesit, Drejtorë e Teknikët e Arsimit të cilët në fund të vitit shkollor 1943-1944 kanë plotësuar rregullisht 15 vjet shërbim në degët e Arsimit, ngrihen në një gradë ma naltë nga ajo që u takon në bazë të titujvet të studimit. Kurse ata që kanë 30 vjet shërbim kalojnë dy gradë më naltë. Përrjashtoheshin nga kjo ngritje në grada më të nalta “a) Shërbëtorët e shkollave e të zyrave b) mësuesit e rinj, të cilët, si mbas shkresës të përmendun ma nalt, nuk kanë rrogë por shpërblim fiks fr.sh. 550 në mual, c) Mësuesit e vjetër filloristë dhe mësuesit e vjetër që kanë ma pak se katër vjet shkollë të mesme dhe nuk zotërojnë tituj studimi të njëvlefshëm me semimaturën.

II. Teknikët e Arsimit të N/Prefekturave, të cilët, veç shkollës së mesme kanë krye një Akademi së paku dyvjeçare ose një institut studimesh të nalta dyvjeçar si dhe ata Teknikë që provojnë me dokumente se kanë dhënë së paku gjysmat e të tanë provimeve që duhen dhanë për fitimin e titullit të plotë Universitar (liçencë, doktorat), hyjnë në kategorin’e Teknikëve të Prefekturave”⁴².

Ministria e Arsimit në një kërkesë të saj, Nr. 1279/5, datë 14.8.1945 “Mbi kategorizimin e arsimtarëve” drejtuar Këshillit të Ministrave, do të kërkonte një vlerësim më të mirë material për arsimtarët lidhur kjo edhe me kontributin e tyre në mësimdhënie, në luftën për zhdukjen e analfabetizmit, përpilimin dhe përmirësimin e teksteve shkollore etj. Gjithashtu “... në kategorizimin e ri, do të tërhiqej vëmendja në këtë

⁴¹ AQSH, F. 511, V. 1945, D. 26, fl. 11.

⁴² Po aty, D. 29, fl. 1. Qarkore e Ministrisë së Arsimit, Nr. 679/6, dt. 18.4.1945.

kërkesë, nuk asht marrë parasysh vjetërsija në shërbim. Dihet se ky kategorizim asht provizor dhe se çështja e vjetërsisë ka për t'u shqyrtue ma vonë, por megjithatë nuk besojmë se me shqyrtimin e çështjes ka për t'u ba mbrenda një kohe të shkutën. Për Dikasteret e tjerë, vjetërsia në shërbim nuk ka aq rëndësi ose të mos njëfjet fare, por n'arsim kjo asht e domosdoshme, sepse arsimtarët nuk kanë tjetër gradim dhe do të ngjallej një pakënaqësi e madhe ndër ta sikur të viheshin në një gradë arsimtarët që kanë 20 vjet shërbim dhe të tjerë që porsa kanë lënë bankat e shkollave”⁴³. Për këtë qëllim i propozojë Kryeministrisë, se: “Vjetërsia do të jetë pesëvjeçare dhe do të shpërblehet 80 Fr.shq. për arsimin e mesëm dhe 60 fr.shq. për arsimin filluer.

Është fakt se, një pjesë e mirë e kuadrit arsimor që punonte në shkollat e rrethit të Fierit, kishte ardhur nga rrethet e tjera të Shqipërisë. Me pagat mujore që merrnin ata kujdeseshin edhe për familjet e tyre. Këshillat Popullore, shumicës së mësuesve nuk kishin ende mundësi t'u siguronin kushtet jetësore më elementare, siç ishte banesa.

Mësuesit përballeshin edhe me mungesa të shumë artikujve të domosdoshme për jetesë si dhe punonin në kushte të papërshtatshme. “Ai, do të thuhej në një dokument të kohës, është i shtërguar shpesh herë të punojë në kondita të vështira. I mbyllur në një dhomë me 40 e më tepër fëmijë, të shumtën e rasteve në lokale antihigjenike e të papërshtatshëm që e pengonin atë mjaft në punën e tij. Gjendje e këtillë mbretëronte në shumë vende të Shqipërisë. Puna e mësonjësve është mjaftë e lodhshme dhe kjo çmohet nga të gjithë. Prandaj gjëndja materiale e tyre është një problem që i duhet zgjidhur me një mënyrë të drejtë”⁴⁴.

Ministria e Arsimit, në një raport tjetër justifikues, të po kësaj periudhe do të theksonte, se: “Me zgjerimin e rrjetit t'arsimit fillor një numër i madh mësuesish kryejnë detyrën në katunde. Në mjaftë raste ata gjejnë përkrajen dhe ndihmën e mundëshme të fshatarëve ose organeve të pushtetit lokal, por po ndodh shumë herë që në mjaft vende mësuesit gjënden përpara disa vështirësirash, me të cilat i pengojnë në kryerjen e detyrës së tyre duke iu humbur dhe ditë pune nga shkolla. Këto vështirësi kanë qenë dy: 1) banimi dhe zjarri, 2) çështja e furnizimit”⁴⁵.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty, V. 1947, D. 17, fl. 29. Raport i Ministrisë së Arsimit: Rreth kuadrit arsimor.

⁴⁵ Po aty, F. 490, V. 1949, D. 66, fl. 3-4.

Për të siguruar këto, në një kohë kur shteti ishte i interesuar për forcimin e arsimit në fshat, Këshilli i Ministrave, me një Vendim të posaçëm, Nr. 421, të datës 10.9.1949, do të përcaktonte se: “1. *Arsimtarëve që kryejnë detyrën në fshatrat jashtë vendbanimit të përhershëm të tyre duhet t’u sigurohet nga ana e fshatit, banimi dhe të ngrohtit pa pagesë.*

2. *Për të siguruar më shpejt furnizimin e arsimtarëve në fshat dhe për t’evituar humbje kohe dhe pune, organet e Tregtisë ose kooperativat e shit-blerjes t’i japin precedencë furnizimit t’arsimtarëve për të mos e penguar atë në punën e shkollës dhe t’i japin atij të gjitha lehtësitë e mundëshme në këtë drejtim mbrenda ligjeve e udhëzimeve në fuqi”⁴⁶. Masat e marra lehtësuan deri diku gjendjen e mësuesve, sidomos atyre të fshatit që përbënin edhe shumicën.*

*

* *

Thellimi i përpjekjeve për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrit

Në fillim të viteve 50-të, vendi hyri në një fazë të re zhvillimi. Periudha e rindërtimit ndonëse me shumë vështirësi, ishte kapërcyer. Në disa sektorë ishin arritur treguesit e paraluftës, duke krijuar mundësi, për futjen graduale të vendit në normalitet. Shkolla ishte fuqizuar.

Në prillin e vitit 1952, udhëheqja komuniste do të deklaronte se, si detyrë themelore strategjike e planit të parë pesëvjeçar do të ishte "shpejtimi i ritmeve për ndërtimin e bazave ekonomike të socializmit". Në rrethin e Fierit, ky plan parashikonte shtrirje të rrjetit arsimor, rritje të numrit të nxënësve në masën 3,5 herë në raport me 1938-ën, si dhe të mësuesve, nga 348 mësues, në vitin 1950-1951, parashikohej që në fund të pesëvjeçarit, numri i tyre të arrinte në 459⁴⁷. Rritja efektive prej 111 mësuesish, do të realizohej nëpërmjet përgatitjes në institutet e larta, shkolla pedagogjike dhe kurse.

Sipas një vendimi të posaçëm të Këshillit të Ministrave të vitit 1952, mësuesit mbi 40 vjeç, do të kualifikoheshin, pa u shkëputur nga puna nëpërmjet formave të ndryshme në shkallë zone e rrethi. Ndërsa shumica dërrmuese që ishte pa arsimin përkatës, do të ndiqte studimet me

⁴⁶ *Po aty.*

⁴⁷ *Po aty*, V. 1952, D. 103, fl. 4.

korrespondencë në shkollat pedagogjike dhe në Institutin Pedagogjik në Tiranë.

Duke analizuar gjendjen reale të rrethit, mendojmë se këto objektiva ishin të tepruara. Rritja më e madhe e personelit të mësuesve deri në këtë periudhë, i përkiste kryesisht arsimit fillor, i cili u përgatit kryesisht nëpërmjet kurseve të përshpejtuara. Shkollat nuk siguronin një sasi të konsiderueshme mësuesish sepse rrjeti i tyre ishte ende i kufizuar. Zgjerimi dhe shtrirja e arsimit 7-vjeçar në rrethin e Fierit, gjatë kësaj periudhe, shtronte kërkesa për mësues më të kualifikuar në raport me ata të arsimit fillor. Deri në vitin 1952, ishin kualifikuar në Tiranë, 78 mësues, nga zona Fier-Mallakastër, prej të cilëve 36 i takonin vetëm rrethit të Fierit⁴⁸. Çdo vit, në bazë të një plani, vijoi kualifikimi i një numri të konsiderueshëm mësuesish edhe nëpërmjet seminareve dhe konsultave me mësues të përgatitur dhe drejtorë shkollash.

Seksioni i Arsimit, të rrethit të Fierit, në këtë periudhë i kushtoi vëmendje sidomos rritjes së nivelit profesional të mësuesve nëpërmjet zgjatjes së afateve kohore të kurseve deri në 6-muaj si dhe, përfshirjes të sa më shumë elementëve që kishin përfunduar arsimin 7-vjeçar. Përgatitja e mësuesve për shkollat 7-vjeçare dhe të mesme, me një nivel profesional më të lartë, ishte dhe mbeti për një kohë mjaft të gjatë një çështje e mprehtë. Fenomeni i tërheqjes së mësuesve më të mirë nga shkollat fillore, nuk e zgjidhi problemin dhe, për më tepër dobësoi këtë të fundit. Përgatitja e mësuesve të rinj nëpërmjet shkollave pedagogjike ishte një proces i vështirë. Kjo kategori shkollash për vetë vështirësitë që paraqiste profesioni i mësuesit, ishin më pak të preferuara në raport me profesione të tjera.

Ndonëse, rreth 80-90% tërhiqeshin në këto shkolla nëpërmjet bursave, asnjëherë plani i nxënësve në shkallë vendi për këto vite nuk u realizua. Për më tepër, një pjesë e mirë e tyre, nuk i përfundonin, duke ulur numrin e kuadrit të ri pedagogjik. Kështu, plani i bursave për këto shkolla në vitin 1951-1952, u realizua vetëm 86,59%, në vitin 1952-1953 rreth 84,36%, duke rënë në 78,46% për vitin 1953-1954⁴⁹. Kuptohet, që edhe rrethi i Fierit, nuk bënte përjashtim nga kjo dukuri e përgjithshme.

Shqetësimi kryesor i organeve arsimore e ato partiake të rrethit të Fierit, krahas sigurimit të kuadrit, vazhdoi të mbetej mbajtja nën kontroll

⁴⁸ *Po aty*, fl. 6.

⁴⁹ *ASHVL*, F. 117, V. 1954, D. 327, fl. 7.

të plotë i problemit të respektimit rigoroz të kriterëve për përgatitjen e tij. Njëpërmjet udhëzimeve të herëpas herë që jepte udhëheqja komuniste, kërkohet që këto organe "të luftonin shumë më tepër për përmirësimin e përbërjes shoqërore të kuadrit arsimor"⁵⁰.

Procesi u stimulua edhe njëpërmjet sistemit të bursave. Komiteti Ekzekutiv i qytetit të Fierit, në bashkëpunim me organet e partisë dhe organizatat e masave, ishin ato që përzgjidhnin mbi bazën e "kriterit biografik", elementet, që do të ndiqnin shkollat e mesme pedagogjike dhe ato të larta. Ky ishte dhe mbetet këndvështrimi i vetëm i trajtimit të problemit të përgatitjes së mësuesve. Në këtë kuadër, vit pas viti, numri i elementeve me origjinë punëtore e sidomos fshatare të varfër, në shkollat pedagogjike, erdhi në rritje. Ndërkohë, u ul në minimum sasia e nxënësve me origjinë nga shtresat e pasura.

Duhet theksuar, se rritja sasiore, në rrethin e Fierit, nuk u shoqërua me tregues të njëjtë cilësor. Nga pikëpamja sasiore rritje më të madhe në këto vite, vijoi të kishte përgatitja e kuadrit për arsimin fillor dhe deridiku, ai për arsimin 7-vjeçar. Për mungesë kuadri shumë maturan të fierakë të shkollave pedagogjike, që normalisht duhej të punonin në arsimin fillor, u emëruan në arsimin 7-vjeçar, duke çuar në uljen e nivelit të kuadrit me arsim përkatës respektivisht 3% në arsimin 7-vjeçar dhe 6% në arsimin e mesëm, në krahasim me vitin 1950⁵¹.

Vit pas viti, duke u nisur nga pikëpamja e sigurimit të kuadrit vendas, njëpërmjet sistemit të bursave për shkollat pedagogjike, u tentua në tërheqjen e sa më shumë nxënësve nga rajonet e largëta fshatare. "*Mësuesit që mbarojnë shkollat pedagogjike përgatiten kryesisht për fshatin, - thuhet në një raport të Ministrisë, - kurse një pjesë e mirë e tyre janë nga qyteti. Duke vazhduar të përgatisim mësues nga qyteti dhe duke e shtruar si detyrë patriotike para tyre vajtjen në fshat, në të njëjtën kohë duhen tërhequr më shumë të rinj nga fshati në shkollat pedagogjike dhe institutet dyvjeçare*"⁵².

Në shumicën e shkollave të rrethit, punonin vetëm 38 kadro arsimore vendase, pa folur për zonat e thella e të largëta si Ruzhdië, Strum, Gjynaqare, Drenje, Verbas, Grykë, Kasnice etj., ku mungesa e

⁵⁰ *Po aty*, D. 328, fl. 3-8.

⁵¹ *Po aty*, D. 329, fl. 19.

⁵² *AQSH*, F. 490, V. 1958, D. 335, fl. 2-21. Vendim i Byrosë Politike e KQ të PPSH: Mbi përmirësimin e punës në shkollë, nr. 249, dt. 31.7.1958.

kuadrit vendas, kushtëzohet edhe nga mungesa e kontigjentit të nxënësve që përfundonin shkollat 7-vjeçare⁵³. Duke parë gjendjen Ministria e Arsimit, do të kërkonte nga Seksioni i Arsimit në Fier, që të merrte të gjitha masat për të zbutur efektet negative në drejtim të plotësimit të kuadrit arsimor vendas. Sipas të dhënave të vitit shkollor 1955-1956, përbërja e mësuesve të fshatit ishte 70 qytetare dhe 90 fshatare⁵⁴. Numri i mësuesve pa shkollë përkatëse ishte gjithashtu i lartë. Në arsimin fillor dhe parashkollor kishin arsimin përkatës vetëm 50% e tyre, në arsimin 7-vjeçar, 27% dhe në të mesmin 65%⁵⁵.

Në vitin shkollor 1956-1957, në rrethin e Fierit, u hap e para shkollë e mesme e përgjithshme 4-vjeçare, që fillimisht u ndoq nga 76 nxënës⁵⁶. Një pjesë e maturantëve të parë më vonë vazhduan studimet në fakultetet e mësuesisë duke ndikuar pozitivisht në rritjen e sasisë së kuadrit vendas, rritje që ilustron në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra e kuadrit arsimtar në Rrethin e Fierit në vitin 1961⁵⁷

| Kategoritë e shkollave ose specialiteti | Gjithsej | Kuadri jo vendas |
|---|----------|------------------|
| Arsimi Parashkollor | 66 | - |
| Arsimi Fillor | 452 | 3 |
| Arsimi 7-vjeçar | 265 | 10 |
| Arsimi Mesëm | 23 | 11 |
| Gjithsej | 806 | 13 |

Gjatë vitit shkollor 1958-1959, duke u nisur nga nevoja e ngritjes dhe kualifikimit të kuadrit arsimor, një pjesë e tij kaloi në kurse kualifikimi të organizuara pranë Institutit të Prefeksionimit në Tiranë, për arsimtarët e shkollave 7-vjeçare e të mesme dhe pranë kabinetit pedagogjik të rrethit, për arsimtarët e shkollave fillore.

Për të vendosur punën mbi baza më të organizuara Këshilli i Ministrave, më 11 nëntor 1958 do të nxirrte një vendim të posaçëm ku theksohej, se duhet: “... të shpejtohet ritmi i përgatitjes së kuadrit

⁵³ ASHVL, F. 117, V. 1954, D. 327, fl. 7.

⁵⁴ Po aty, fl. 8.

⁵⁵ AQSH, F. 511, V. 1957, D. 46, fl. 3.

⁵⁶ Po aty, fl. 6.

⁵⁷ Vjetari Statistikor i RPSH, Tiranë 1962, fl. 251-275. Kapitulli XIII Arsimit dhe kultura: Të dhënat e vitit 1961-1962.

t'arësimit në menyrë që në fund të planit të III-të pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë, përqindja e kuadrit me arësim përkatës të jetë afërsisht si vijon: në arsim fillor 90%, n'atë shtatëvjeçar 80% dhe në të mesmin 100%⁵⁸.

Për zbatimin e këtij vendimi Seksioni i Arsimit në rrethin e Fierit, në bashkëpunim me kabinetin pedagogjik, morën masa të reja për përmirësimin e punës kualifikuese të arsimtarëve dhe rritjen e efikasitetit të formave të ngritura për këtë qëllim. Rëndësi e veçantë iu kushtua sidomos kurseve të kualifikimit të hapura në Berat e Vlorë të cilat i përfunduan me sukses mbi 300 mësues të shkollave fillore⁵⁹. Instituti i Prefeksionimit, nga ana tjetër krahas furnizimit me programe dhe materiale metodike dërgoi në rrethin e Fierit, specialistët e vet, me qëllim mbarëvatjen e punës në kabinetin pedagogjik.

Për kualifikimin profesional të kuadrit, rëndësi vijoi t'i jepej punës në rrethet metodike si dhe në shkollat e qyteteve të Fierit dhe të Ballshit. Një punë më profesionale, u zhvillua sidomos, pas vitit 1957 kur, sipas një organizimi të ri u shkrinë rrethet metodike në shkollat e fshatit, duke u grupuar në një drejtori në varësi të shkollave 7-vjeçare. Ato ishin direkt përgjegjëse për punën mësimore-edukative, dhe për të gjitha problemet e tjera të shkollave fillore, që vareshin prej tyre. Kjo formë e re kishte si qëllim, që të ndihmonte më shumë shkollat dhe të përforconte disiplinën në punë⁶⁰.

Drejtorët e shkollave shtatëvjeçare u lehtësuan nga norma e punës së tyre, për të rritur kohën për kontroll e ndihmë të shkollave të grupuara. Kjo formë pune lidhte më mirë seksionin e arsimit me shkollat dhe siguronte një njohje më të mirë të problemeve, duke sjellë edhe përmirësimin e disiplinës në punë. Më parë kishte largime pa leje të kuadrit në shkolla edhe pa arsye të forta. Shkolla mbyllej dhe nxënësit mbeteshin pa mësim, sepse mësuesin nuk e kontrollonte kush në fshat⁶¹. Gjithashtu, organizimi i ri siguronte ndërkohë rezultate më të mira edhe për unifikimin e punës metodike, planifikimin e lëndës, përdorimin e

⁵⁸ AQSH, F. 490, V. 1958, D. 335, fl. 31-35. Vendim i Këshillit të Ministrave: Mbi përmirësimin e punës në shkollë, Nr. 487, dt. 11.XI.1958.

⁵⁹ ASHVL, F. 117, V. 1968, D. 322, fl. 1-11.

⁶⁰ AQSH, F. 490, V. 1957, D. 226, fl. 1-4.

⁶¹ Po aty.

mjeteve mësimore etj. Kontrolli e ndihma ishin më prezente, si rezultat edhe cilësia ishte më e mirë⁶².

Një institucion tjetër që ndihmoi për kualifikimin e kuadrit dhe vendosjen e procesit mësimor mbi baza më shkencore, ishte *Kabineti Pedagogjik*. Kështu, në gusht të vitit 1958, një nga 10 kabinetet pedagogjike që u ngritën në Shqipëri ishte edhe Kabineti Pedagogjik i rrethit të Fierit, drejtor i parë i të cilit ishte Muharrem Biçoku⁶³.

Lidhur me rolin e punës së Kabinetit Pedagogjik, në një dokument të kohës, do të thuhej se: “... ai shërbente për kulifikimin e mësonjësve të shkollës dhe për të ndihmuar praktikantët në përgatitjen e tyre për mesimin e provës. Kabineti pedagogjik është qendra e aktivitetit pedagogjik të rrethit; shërben për konsultime pedagogjike të vetë profesorëve dhe të kandidatëve me profesorët, metodistëve e mësonjësve të ushtrimes; shërben gjithashtu si vend punimi për përgatitjen e mjeteve të mësimi dhe vend studimi për përgatitjen e koncepteve. Drejtimin dhe organizimin e kabinetit pedagogjik e ka profesori i pedagogjisë, kurse për rregullimin dhe kujdesin e brendëshëm të tij caktohet një nga mësuesit e ushtrimes”⁶⁴.

Ky institucion arsimor, luajti një rol të rëndësishëm në afirmimin e mësuesve të niveleve të ndryshme, duke punuar me programe të posaçme, organizuar seminare, kurse, leksione e forma të tjera, përfshirë përgatitjen dhe zhvillimin e konferencave pedagogjike. Kabineti Pedagogjik, nëpërmjet rretheve pedagogjike, të cilat mblihdeshin një herë në muaj, ndihmoi në përgjithësimin e përvojës së përparuar, duke organizuar mësim të hapura, praktikume, tema shkencore etj. Paskëtaj kualifikimi, organizohej në tri nivele:

- a) Brenda shkollës, nëpërmjet këshillit pedagogjik nga drejtorja e shkollës.
- b) Në shkallë zone, nëpërmjet rretheve metodike nga kabineti pedagogjik.
- c) Në shkallë rrethi, nëpërmjet kabinetit pedagogjik⁶⁵. Detyrat e kabinetit për kualifikimin e mësuesve, kontrollin e shkollave, për nivelin e njohurive të nxënësve, përvetësimin e programeve etj., kryheshin nga metodistë, specialistë të disiplinave të ndryshme dhe secili specialist për sektorin që mbulonte, kishte veprimtarinë e vet si mësues, në fushën përkatëse.

⁶² *Po aty*.

⁶³ *Po aty*.

⁶⁴ *AQSH*, F. 511, V. 1958, D. 30, fl. 69.

⁶⁵ *Po aty*, fl. 71.

Kabineti Pedagogjik i rrethit të Fierit, gjatë gjithë periudhës të marrë në studim, punoi për futjen e programeve dhe teksteve të reja në procesin mësimor, kualifikimin e mësuesve të rinj, eksperimentimin e teksteve të reja, zbërthimin e udhëzimeve, materialeve të tjera normative që lidheshin me shkollën dhe punën e saj, hartimin dhe botimin e materialeve me karakter metodik, hapjen e kurseve afatshkurtra për probleme të veçanta, përpunimin e informacioneve shkencore etj. Gjithashtu, Kabineti i kushtoi vazhdimisht vëmendje punës për njohjen e metodave të reja pedagogjike-shkencore etj.

Gjithashtu, kuadrit arsimor në rrethin e Fierit ashtu si gjithë mësuesve të vendit u kërkohet të interpretonin dhe të popullarizonin ideologjinë dhe politikën e Partisë, si do të vinte në dukje një autor perëndimor t'i thurnin elozhe heronjve të rinj të socializmit: ushtarit, punëtorit, fshatarit, mësuesit, kuadrit komunist, "burrit të ri" dhe "gruas së re". Ata duhet të ishin të gjithë revolucionarë, plotësisht të përkushtuar për krijimin e një Shqipërie socialiste, pavarësisht nga rrethimi i jashtëm armiqësor i kapitalistëve, revizionistëve dhe imperialistëve dhe i disa lakejve tradhtarëve të brendshëm⁶⁶.

Duke përfunduar mund të thuhet se në vija të përgjithshme, kuadri arsimor, u rrit nga 368 mësues në vitin 1950, në 806 në vitin 1961⁶⁷ rrjedhojë kjo e hapjes së shkollave të reja dhe e shtimit të kërkesës për kuadro. Brenda kësaj rritjeje, padyshim ekzistonin diferenca, në raport me progresin real të arritur, dukuri kjo, e njohur, nga e cila, natyrisht nuk bënte përjashtim, zona e Fierit dhe Mallakastrës. Por, duhet pranuar se me gjithë defektet në sistemin e përgatitjes së kuadrit, nga pikëpamja sasiore treguesit ishin pozitivë.

Duke iu referuar burimeve zyrtare, rezulton, se: "*Nëpërmjet shkollave pedagogjike dhe arsimit me korrespondencë, u bë e mundur që në vitin 1960, 370 mësuesit që jepnin mësim në shkollat fillore të rrethit të Fierit të kishin arsimin e plotë pedagogjik dhe që të ishin të gjithë vendas*"⁶⁸.

Në përgatitjen e kuadrit, u punua, që mësuesit të ishin nga zonat ku ata banonin familjarisht dhe në shumë raste edhe nga fshatrat e tyre. Vlen të theksohen gjithashtu, përpjekjet e bëra nga arsimtarët e rrethit të Fierit,

⁶⁶ Edwin Jacques, *Shqiptarët. Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Kartë e Pendë-Tiranë, 1995, f. 508.

⁶⁷ Jani Sota, *Zhvillimet arsimore në rrethin e Fierit*, monografi në proces botimi, f. 212.

⁶⁸ ASHVL, F. 117, V. 1968, D. 322, fl. 1-11.

për tërheqjen e sa më shumë mësueseve femra. Sipas statistikave të kohës, mbi 50 për qind e mësuesve ishin femra⁶⁹ dhe një pjesë e tyre drejtonin punën mësimore dhe edukative në shkolla⁷⁰. Pjesë e kuadrit që kontribuoi në zhvillimin arsimor të rrethit të Fierit ishin padyshim edhe shumë mësues të ardhur nga rrethet e tjera të Shqipërisë si: Tirana, Durrësi, Elbasani, Berati, Lushnja, Gjirokastra, Vlora etj.

S u m m a r y

THE ROLE OF FIERI'S TEACHERS IN THE EDUCATION REFORMS OF 1945 - 1960

With the end of World war II, the Albanian school went through several radical transformation, which had an impact on assuring and preparing the teaching staff. During all this period, the Party on power took numerous measures for the professional preparation of a teacher, who would reach the Party's aim; the education of the new generations with its ideology. The treatment of this problem in a regional level is thought to contribute modestly to complete the general mosaic. The role of the teacher within the education process has been and still is irreplaceable. He is the one who organizes, orients and directs this process.

The period between 1945-1960 represents one of the most interesting phases in the history of the Albanian education, during which numerous efforts were made, firstly for the creation of the educational staff, which as through the entire country, lacked in the region of Fier as well, and secondly for the reformation of the teachers in accordance with the policy of the communist state.

The state and party authorities, did not aim only the recruiting of as many teachers as possible, but what was more important to them was that the "new" teacher should be prepared to accept and defend the policy of the new party-state. On these basis, there was work made, not only to grow the number of the teachers, but also to provide a communist education to the old and new teachers. Those were two of the principal directions of the official Albanian policy, after the war.

⁶⁹ *Po aty.*

⁷⁰ *Po aty.*

It is worth emphasizing the efforts of the teachers of Fier, in order to recruit as many women teachers as possible. According to the time's statistics, over 50% of the teachers were women and part of them would even direct the teaching and educational work in schools. Part of the staff that contributed to the education development in the region of Fier were undeniably many teachers coming from other regions of Albania, such as Tirana, Berat, Lushnja, Gjirokastër, Vlora etc.